



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Përmblenë / Predato Received / Delivery	29.12.2021	1	viti god year
Organ / Institucioni Org / Instit	6420/2021	Shërbimi Prillog Appendix	Sasia Kohëzgjatësi Quantity
SKRIPSHICK			115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.932/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.932/2021 të datës 15.11.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Av. me adresë rr."Fehmi e Xhevë Lladrovci", p.nr. Komuna e Drenasit, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.932/2021 e datës 15.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

**II. MBETET NË FUQI** Urdhëresa me numër të referencës 07/01-01SAP/-P-8058 për ekzekutimin e vendimit e datës 06.10.2021 i Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ndaj ankuesit i punësuar në Policinë e Kosovës sipas kontratës me numër të referencës 07/1-01A/0448 të datës 25.08.2014 në pozitën "Zyrtar i Personelit", në Drejtorinë Rajonale të Policisë së Prishtinës/Divizioni i Sigurisë Publike Njësia Stacioni Policor Glllogoc-Sektori i Resurseve-Zyra për Personel dhe Administratë, Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë, me datë 06.10.2021 Drejtori i Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës me numër të referencës 07/01-01SAP/-P-8058, ka nxjerrë urdhëresë për ekzekutimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për ankuesin bazuar në Aktgjykimin e

Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Krime të Renda me numër PAKR,193/19 të datës 09.08.2019, i cili ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.356/17 të datës 15.02.2019.

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij ligjor me datën 15.11.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5436/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për anulimin e urdhrit për ekzekutimin e vendimit Nr.07/1-01SAP-P/8058 të datës 06.10.2021 e lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 18.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Policinë e Kosovës ndërsa Policia e Kosovës me datën 07.12.2021, përmes Departamentit për Burime Njerëzore, ka përcjellë gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

*Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër A.nr. 932/2021, të datës 15.11.2021; Urdhëresën për ekzekutimin e vendimit të datës 05.10.2021 nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës; Vërtetimin e punësimit të datës 06.10.2021 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 07.12.2021 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kontratë e punës së ankuesit e datës 14.01.2004; Shkresë zyrtare nga drejtoria për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës nga Policia e Kosovës lidhur me lëndën disiplinore të ankuesit me numër 694-PK-2014; Shkresa zyrtare e datës 01.03.2021 nga Drejtoria për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës për ankuesin; Njoftim i datës 04.09.2014 lidhur me rastin me numër te referencës IPK/DH/55/14/VP nga Inspektorati Policor i Kosovës; Kallëzim penal i datës 04.09.2014 për ankuesin nga Inspektorati Policor i Kosovës; Njoftim i datës 11.07.2013 Drejtoria Rajonale e Policisë-Prishtinë; E-maili zyrtar i datës 10.07.2013; Raport i zyrtarit policor i datës 09.07.2013; Formular lidhur me marrjen në pyetje të palës nga Inspektorati Policor i Kosovës; Lista mbi evidencën e pushimeve të ankuesit e datës 19.09.2013 nga Policia e Kosovës; Raport i datës 08.01.2014 për marrjen në pyetje të dëshmitarit-viktimës; Raport i datës 09.07.2014 për marrjen në pyetje të dëshmitarit-viktimës; Raport i datës 07.07.2014 për marrjen në pyetje të dëshmitarit-viktimës; Raport i datës 29.07.2014 për marrjen në pyetje të dëshmitarit-viktimës; E-maili zyrtar 03.03.2014; Raport i datës 07.07.2014 për marrjen në pyetje të dëshmitarit-viktimës; Raport i datës 07.07.2014 për marrjen në pyetje të dëshmitarit-viktimës; Raport i datës 21.08.2014 për marrjen në pyetje të dyshuarit; Njoftim zyrtar i datës 10.10.2014 për fillimin e hetimeve te brendshme për ankuesin; Lista mbi evidencën e pushimeve të ankuesit e datës 29.09.2014 nga Policia e Kosovës; Vërtetim i datës 29.09.2014 mbi verifikimin në bazën e të dhënave në DSP për hetime të brendshme; Aktgjykim me numër PAKR.nr.193/19 i Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Renda lidhur me ankuesin; Aktgjykim me numër PKR.nr.356/17 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Renda; Urdhëresë e datës 02.06.2020 për kërkimin, ndalimin, arrestimin dhe dërgimin e të dënuarit në institucionin për mbajtje të dënimit në institucionin për mbajtje të dënimit-shërbimin korrektues të Republikës së Kosovës-Qendra e Paraburgimit në Prishtinë; Vendim i datës 28.02.2018 mbi suspendimin e përkohshëm në kohëzgjatje prej 48

orë për ankuesin; Shkresë zyrtare e datës 02.03.2018 mbi suspendimin e përkohshëm të ankuesit nga Policia e Kosovës; Urdhëresë e datës 05.03.2018 mbi ekzekutimin e vendimit mbi suspendimin e përkohshëm të ankuesit nga puna nga Policia e Kosovës ; E-maili zyrtar i datës 10.10.2019; E-maili zyrtar i datës 09.01.2020; E-maili zyrtar i datës 09.01.2020; E-maili zyrtar i datës 07.11.2019; E-maili zyrtar i datës 07.11.2019; Vendim i datës 27.10.2014 mbi pezullimin e hetimeve disiplinore; Kërkesë e datës 24.10.2014; Shkresë zyrtare e datës 23.10.2014 mbi pezullimin e rastit me numër 694-PK-2014; Shkresë zyrtare e datës 08.10.2014 mbi zingjirin e

ruajtjes se lendes hetimore me numër Nr.694/PK 2014; Aktgjykim me numër PKR.nr.356/17 i datës 15.02.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda mbi plotfuqishmërinë e tij; Vendim i datës 28.07.2021 nga Komisioni Disiplinor i Policisë së Kosovës; Urdhëresë për ekzekutimin e vendimit e datës 05.10.2021 nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 06.10.2021; E-mailat zyrtar të datës 05.10.2021 E-maili zyrtar i datës 01.10.2021; E-maili zyrtar i datës 09.09.2021; E-mailat zyrtar te datës 01.10.2021; E-maili zyrtar i datës 23.09.2021; E-maili zyrtar i datës 09.09.2021; E-maili zyrtar i datës 09.09.2021; E-maili zyrtar i datës 07.09.2021; E-maili zyrtar i datës 06.09.2021; E-maili zyrtar i datës 07.09.2021; E-maili zyrtar i datës 06.09.2021; E-maili zyrtar i datës 23.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të fakteve dhe provave nga shkresat e lëndës, ka konstatuar se sipas Vendimit të datës 28.02.2018 me numër Ref 04 1-01 003 2018 të Drejtorit të Departamentit për Operacione në Policinë e Kosovës, ankuesi është pezulluar në kohëzgjatje prej 48 orë, ndërsa me datën 02.03.2018 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës ka nxjerrë vendimin mbi vazhdimin e suspendimit të përkohshëm nga puna të ankuesit. Me datën 15.02.2019 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda ka nxjerrë Aktgjykimin me numër PKR.nr.356/17 sipas të cilit ankuesin e ka shpallur fajtor për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj. Me datën 02.06.2020 Gjykata Themelore në Prishtinë, lëshon Urdhërese me numër 1531/19 për kërkimin ndalimin arrestimin dhe dërgimin e të dënuarit në Institucionin për mbajtje te dënimit për për ekzekutim nga Stacioni Policor-Drenas dhe Njësive të Policisë Kufitare. Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës, me datën 06.10.2021 ka nxjerrë urdhëresë mbi ekzekutimin e vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për ankuesin bazuar në Aktgjykimin me numër PAKR.193/19 të datës 09.08.2019 nga Gjykata e Apelit-Departamenti për Krime të Rënda me të cilin është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me numër PKR.356/17 të datës 15.02.2019 mbi fajësinë e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili ka pretenduar se organi i punësimit nuk ka zhvilluar procedure disiplinore dhe se nuk ka themeluar komision disiplinor qe është dashtë te vendose ne shkalle te pare si dhe ka kërkuar



nga Këshilli që të anulohet urdhëresa e datës 06.10.2021 e Drejtorit të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar sepse Drejtori i Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes se urdhëresës për ekzekutimin e vendimit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës për nëpunësin civil ka vepruar në pajtim me nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër"*, ku në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmimeve të ofruar nga organi i punësimit konkretisht nga Aktgjykimi me numër PKR.356/17 i datës 15.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda ka konstatuar se ankuesi ne baze te këtij aktgjykimi është shpallur fajtor, për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422 paragrafi 1, të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj. Ky Aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykim me numër PAKR.193/19 të datës 09.08.2019, dhe është bërë i plotfuqishëm nga data 09.08.2019, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së urdhëresës numër të referencës 07/01-01SAP/-P-8058, të datës 06.10.2021, me te cilin i ka ndërprerë marrëdhënien e punës nëpunësit civil është bazuar në Aktgjykimin me numër PKR.356/17 të datës 15.02.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke gjetur se ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe se i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale dhe është dënuar me burg efektiv për (6) muaj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr parasysh se kjo procedurë ka filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe duke i referuar dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës respektivisht nenit 90 paragrafit 1 dhe 2 nën paragrafit 2.4 i cili përcakton se *"1. Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me krijimin e kushteve dhe fakteve, pavarësisht nga dëshira e nëpunësit civil ose institucioni. 2. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me: 2.4. dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër; si dhe nenin 11 paragrafin 1, 2 nën paragrafin 2.4 dhe nenin 3 të Rregullores Nr. 01/2011 për Pezullimin Ndërprerjen dhe Përfundimin e Marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil e cila përcakton se, "Marrëdhënia e punës së nëpunësit civil përfundon në momentin e krijimit të kushteve apo fakteve, të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi 2. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me: 2.4. dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër; 3. Ndërprerja marrëdhënies së punës, së nëpunësit civil në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni behet me vendim nga udhëheqësi me i lartë administrativ i institucionit përkatës"*, ka konstatuar se në rastin konkret pasi që ankuesi është dënuar me vendim të formës së prerë me burg efektiv për 6 muaj edhe me ligjin për shërbimin civil përfundimi i marrëdhënies së punës është dashur të bëhet vetëm me vendim të udhëheqësi me të lartë administrativ të institucionit pa u zhvilluar procedurat disiplinore.




Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr parasysh se kjo procedurë ka filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, por e njëjta ka vazhduar edhe në kohën kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, si dhe duke iu referuar dispozitave transitorë gjegjësisht nenit 83 paragrafit 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, i cili përcakton se „*Procedurat që janë në vazhdim e sipër, kur ky ligj hyn në fuqi, do të vazhdojnë sipas ligjit të ri*” konstaton kjo procedure është dashur të zhvillohet sipas ligjit të ri respektivisht Kolegji konstaton se ndërprerja e marrëdhënies së punës për ankuesin nga ana e Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës është bërë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht në pajtim me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 dhe 1.6 si dhe nenin 4 nën paragrafin 4.1.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.932/2021**

Ardita Perçuku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit *av*
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.